

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

**31.01.2023
Ora 13:54**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|---------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ: | Y. Merkaj, B. Kodra |
| • Parti | Politike: | PDIU, PL |
| • Të | tjerë: | KRIIK |

Zj. I. Nano: Mirdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator. Sekretari i përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës. Mesa shoh janë dhe përfaqësues të partive politike dhe të shoqërisë civile. Në rendin e ditës të njoftuar paraprakisht kemi një akt për shqyrtim aktin “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Para se të fillojmë me shqyrtimin e këtij akti paraprakisht po pyes kolegët nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës të cilën dëshirojnë ta diskutojnë, kolegë? Zonja Vukaj?

Zj. H. Vukaj: Në fakt s'do ta konsideroja çështje jashtë këtij rendi por si sipar i këtij rendi dite për shkak se gjëja e parë që duhet të bëjmë është verifikimi i legjitimitetit të parë dhe prezent. Meqenëse konsideroj se ky është dhe inicimi i një sesioni të ri që i përshtatet zgjedhjeve të reja. Kështu që personalisht besoj që dhe ju jeni dakord për hir të një procedimi të rregullt normues dhe administrativ mbi të gjitha, do të kërkoja nga zoti Sekretar i Përgjithshëm prej tij administratës që të na bënte prezent përfaqësimin formal që lidhet me të nderuarit që janë prezent në sallë dhe ndoshta përfaqësojnë subjekte të caktuara. Faleminderit!

Z. Y. Merkaj: Po! Në fillim të periudhës zgjedhore pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur kërkesa nga Partia PDIU-ja duke caktuar si përfaqësues zotin Shkëlqim Sulo dhe nga Partia Lirisë duke caktuar si përfaqësues zotin Altin Kaziaj, besoj këto të dy janë personat.

Z. I. Nano: Zotëria pas?

Z. Y. Merkaj : Është me PDIU-në.

Z. I. Nano: Dakord. Është zëdhënësi. Janë të pajisur me autorizimin përkatës?

Z. Y. Merkaj: Po, e kanë sjellë nga kryetari i partisë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Zj. I. Nano: Çështje tjetër jashtë rendit të ditës kemi? Përfaqësuesit e partive politike kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës që duan ta diskutojnë për Rregullatorin? Jo!?

Atëherë fillojmë me diskutimin e projektvendimit që kemi në rendin e ditës. Ka ardhur në Komisionin Rregullator me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zoti Sekretar i Përgjithshëm do doja një prezantim të shkurtër të projektaktit dhe relacionit shpjegues.

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Atëherë Kodi Zgjedhor në nenin 20 ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Neni 98, pika 1 ka parashikuar kompetencën e KQZ-së për përgatitjen e fletëve të votimit. Në zbatim të dispozitave të mësipërme, është hartuar projektvendimin “Për miratimin espezifkimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Projektvendimi ka për qëllim të përcaktojë specifikimet teknike të fletëve të votimit që do të përdoren për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Neni 97, pika 2 e Kodit Zgjedhor përcakton se, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fleta votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë. Fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së. Përveç elementeve të sigurisë së letrës, fleta e votimit do të përmbajë dhe disa elementë teknikë në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit si dhe elementë të tjerë identifikues që nuk leçohen me sy të lirë (barcode).

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Elementët e sigurisë dhe elementët teknikë janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në lidhjen nr. 1 dhe nr. 2 që i bashkëlidhen projektvendimi. Komisioni Rregullator nuk mund të shprehet në mënyrë shteruese për dimensionet e fletëve të votimit, e për këtë arsye propozohet që me këtë vendim të miratohen dimensionet minimale të fletës së votimit. Në tekstin e projektvendimit, është përcaktuar se përmasat e fletës së votimit mund të ndryshohen, në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen në zgjedhje brenda afatit ligjor. Duke qenë se tani kemi një praktikë e konsoliduar për specifikimet e fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, referuar edhe vendimeve nr. 104, të vitit 2015 dhe nr. 11, të vitit 2019, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve propozohen dhe specifikimet sipas lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të projektvendimit. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Githashtu sipas lidhjes 1 kemi parashikuar që Lloji i letrës të jetë Watermark 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa. Dimensionet e fletës duhet të jenë sa fleta A4 jo më të vogla se fleta A4, gjerësia është 210 mm dhe gjatësia 297 mm. Orientimi i fletëve të votimit për kryetarët e Bashkisë duhet të jetë portret është propozimi i administratës ndërsa për këshillin e Bashkisë janë të njëjtat specifikime vetëm se orientimi i letrës duhet të jetë në formatin landscape. Faleminderit!

Zj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Në parim përpara se ta kaloj fjalën tek kolegët, përfaqësuesit e partive politike kanë diçka në parim lidhur me projektvendimin? Zoti Kaziaj, zoti Sula? Faleminderit! Kolegë në parim për projektvendimin? Zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit e nderuar. Në parim përpara se të kalojmë në miratimin e projektvendimit unë e lexova me vëmendje relacionin e Sekretarit të

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

përgjithshëm. Besoj autorizimi i Komisionit Rregullator për miratimin e këtij akti me karakter normativ është neni 98 i Kodit Zgjedhor. Titulli i nenit 98 është përmbajtja e fletëve të votimit. Ndërkohë që projektvendimi që ju sot na keni paraqitur për të miratuar është me titull projektvendim “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”. Edhe në mbledhjen e kaluar ku ne bëmë disa ndryshime tek prokejtakti për kamerat është një qëndrim besoj tashmë i konsoliduar edhe me kolegët e Komisionit Rregullator që nisur edhe nga natyra e tagreve që ka përcaktuar ligjvënësi i këtij komisioni, Komisioni Rregullator i KQZ-së nuk është njësi prokurimi. Komisioni Rregullator i KQZ-së miraton normat, rregullat apo karakteristikat teknike të cilat duhet të zbatohen si nga administrata e KQZ-Së po ashtu edhe nga niveli i dyte apo i trete apo nga të tretët i administrimit zgjedhor. Në këtë kontekst unë do ti propozoja edhe kolegëve që përmbajtja e titullit të projektvendimit të ndryshojë duke hequr termin “miratimin e specifikimeve teknike të fletëve të votimit” dhe duke e ndryshuar duke propozuar që titulli i projektaktit që ne do të miratojmë të jetë “miratimi i disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit”.

Zj. I. Nano: Pra “miratimin e disa karakteristikave teknike” sepse nuk janë shpjeguese.

Z. M. Çakaj : Por jo “specifikimeve teknike”.

Zj. I. Nano: Mirë, përpara se të votimin e këtij propozimi jemi në votimin në parim njëherë pastaj në momentin që e fillojmë e fillojmë nga titulli dhe pastaj nen për nen. Pra në parim.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Z. M. Çakaj: Po dakord, referuar rregullores tonë në parim të votojmë projektvendimin me pikën e ndryshuar.

Zj. I. Nano: Dhe pastaj të gjithë ndryshimet e mundshme duke nisur nga titulli deri në nenin e fundit. Kështuqë e mbajmë për një moment më vonë. Zonja Vukaj kishte diçka tjetër për të thënë.

Zj. H. Vukaj: Përsëri në kontekstin e parimit që e shoh në parim ngritjen e këtij shqetësimi nga kolegu shoh që në raport me çfarë është propozuar relacioni nuk është justifikues aspak. Relacioni është i përgjithshëm, ka një narracion aty se çfarë detyrimesh kemi ne që këto i kemi të qarta por nga ana tjetër nuk më justifikon fare këto karakteristikat apo specifikime siç i keni quajtur ju. Pra është një sipërmarrje e madhe të thuash X specifikim apo X cilësi neqoftëse unë nuk kam një specifikim të argumentuar nga ana teknike se ku jeni bazuar zotërinj që kjo mua më jep garancinë maksimale të një flete me standartet më të larta. Pra jep garancinë për votuesin dhe për subjektet politike apo zgjedhore quajeni si të doni që kjo fletë është e pacënueshme, në të gjitha rrethanat. Kështuqë ky akt neqoftëse nuk pajiset me relacioni teknik që jam e sigurtë që ju patjetër keni referenca përsa kohë i keni vënë se nuk janë të mara standart nga një kompjuter. Duhet të pajiset me relacionin teknik ky akt dhe justifikues për të gjitha karakteristikat. Vetëm atherë quhet një akt i plotë. Pra kjo mund të bëhet edhe në momentin kur ne në parim të kemi rënë dakord për këtë akt, të vijojmë dhe më çfarë përbëjn karakteristikat. Por neqoftëse do ngelemi tek detaje detajet duan shpjegime dhe justifikim të përligjur teknik. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Zj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Sapo të vijë te specifikimet apo karakteristikat teknike nëse do ta votojmë propozimin e zotit Çakaj administratës do t'i bëjmë pyetjet e nevojshme lidhur me të gjitha ato karakteristika për të garantuar një fletë votimi të pacënueshme sikundër dhe ju theksuat. Kështuqë kalojmë në miratimin në parim pastaj kalojmë direkt tek propozimi i zotit Çakaj për ndryshimin e titullit. Kolegë!

Kush është dakord në parim me projektaktin?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me pesë vota pro, miratohet!

Kalojmë në trajtimin nen për nen, shqyrtimin nen për nen. Do ta nisim me propozimin e zotit Çakaj për ndryshimin e titullit. Projektvendim për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Jam korrekt me propozimin tuaj?

Kalojmë në votimin e propozimit për ndryshimin e titullit,

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me pesë vota pro, miratohet!

Komisioni Rregullator vendosi:

1- Miratimin e specifikimeve teknike të fletëve së votimit për zgjedhjet (dhe këtu do të duhet të kemi të njëjtin reflektim) për organet qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Votojmë së pari ndryshimin në tekst “disa karakteristika teknike” dhe pastaj kalojmë tek shtojcat.

Kush është dakord?

***Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me pesë vota pro, miratohet!

Kalojmë tek lidhjet 1 dhe 2, janë 2 lidhje në të cilat pa filluar konkretisht me karakteristikat teknike kemi specifikimet e fletës së votimit. Atëherë do të duhet të votojmë disa karakteristika të fletës së votimit për secilën lidhje. Jeni dakord kolegë, kush është dakord? Që propozimi i zotit Çakaj të përfshijë ndryshimet edhe në lidhjen 1 dhe lidhjen 2.

Fillojmë me lidhjen 1 “disa karakteristika të fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Unë do të përpiqem ti lexoj paragraf pas paragrafi qoftë lidhjen 1 qoftë lidhjen 2 për ti mundësuar kolegëve të bëjnë pyetje administratës lidhur me paqartësitë që mund të kenë. Një nga karakteristikat është lloji i letrës, Ëatermark 90 gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, i vazhdueshëm me skicë speciale, me mikroprintime, element në printim që shikohet me rreze ultraviolet. Kjo është karakteristika e parë. Kemi pyetje për administratën? Zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit e nderuar. Nisur dhe nga relacioni që sapo e citoi kolegja, relacioni shoqërues i këtij projektvendimi unë do të dëshiroja të dëgjoja nga administrata e KQZ-së sqarime konkrete lidhur me të gjithë këto karakteristika që sapo ju lexuat.

Zj. I. Nano: Për llojin e letrës.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Z. M. Çakaj: Për llojin e letrës, konkretisht çfarë përfaqëson termi Watermark që në leximin tim duhet të jetë i papërshkueshëm nga uji por megjithatë do të doja ta sqaronte administrata. Pse është vendosur karakteristika teknike 90 gr/m2 dhe jo 89 apo 91 apo 92, 100% pulp e të tjerat me rradhë?

I gjithë ky shpjegim apo sqarim të jepet në raport me përcaktimet e nenit 98 të Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

Z. I. Nano: Administrata? Po zoti Merkaaj!

Z. Y. Merkaaj: Unë me sa kam dijeni për Watermark nuk është e papërshkueshme nga uji por është dendësia e letrës, e copës, është tek fijet që ndërthuren që përbëjnë copën.

Z. M. Çakaj: Ka një term shqip për fjalën Watermark?

Z. Y. Merkaaj: Po! Dantell e thurur me fije të holla të dendura, kështu është. Shqip kështu është.

Z. M. Çakaj: E vendosim shqip.

Zj. I. Nano: Mund ta vendosim shqip dhe në kllapa e vendosim Watermark

Z. M. Çakaj: E vendosim shqip nëse kështu është specifikimi teknik. Dëmethënë karakteristika termi shqiptar Watermark është?

Z. Y. Merkaaj: Dendësia e letrës.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Z. M. Çakaj: Dendësia, mund ta nisim edhe me emrin ose mbiemrin “dendësia”

Z. Y. Merkaj: 100% pulp do të thotë tul.

Z. M. Çakaj: Përpara se të kalojmë tek pulp jemi tek pesha 90 gr/m² çfarë përfaqëson kjo?

Z. Y. Merkaj: Nga eksperiencia e mëparshme 90 gr/m² është që nuk lejon që shënimi që bëhet në faqen e parë të letrës...

Z. M. Çakaj: Pra dendësia? Dëndësia, trashësia. Po!

Z. Y. Merkaj: Nuk lejon që ky shënim të lexohen nga ana tjetër.

Z. M. Çakaj: Atëherë, nëse KQZ-ja do të sigurojë një letër 92 gr?

Z. Y. Merkaj: Është më mirë akoma por jo më pak se 90 gr.

Z. M. Çakaj: Më mirë akoma? Atëherë mos duhet të ishte termi (këtë e kam edhe për kolegët) termi i duhur do të ishte “jo më pak së 90 gr” që çfardolloj, kjo të jetë dyshemeja.

Zj. I. Nano: Pra të jetë një standard minimal.

Z. M. Çakaj: Po!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Zj. I. Nano: Po zoti Kodra?

Z. B. Kodra: Të paktën nga eksperiencat e mëparshme 90 gr është standart teknik pra një letër normale që ne përdorim në përditshmërinë tonë është 80gr është kjo letra. Ndërsa letra Watermark, pikërisht kjo letër që është e përbërë, nga e cila bëhet fleta e votimit në standartin e saj është 90 gr/m² që në vetvete përcakton trashësinë e letrës, ky dimendion. Kështuqë ne mund ta vendosim “jo më pak se” por nëqoftëse kalojmë në më tepër se 90 gr nuk është më letër, kalojmë në karton pastaj.

Z. M. Çakaj: Cili është kufiri midis letrës dhe kartonit, sa gram është kufiri për trashësinë?

Z. B. Kodra: Përgjithësisht të gjitha ato që kalojnë 80 gr quhen letër e trashë ose karton (në varësi të kësaj trashësie).

Z. M. Çakaj: Pra 90 gr është karton?

Z. B. Kodra: Jo!

Z. M. Çakaj: Sepse sapo thatë 80 gr...

Z. B. Kodra: Është më e trashë se letra.

Z. M. Çakaj: Është letër e trashë!?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Z. B. Kodra: Nëqoftëse marrim Watermark që në vetvete (nëse përdorim termin e huaj watermark) janë bashkime të dy letrave, pra dy letra ndërthuren me njëra tjetrën. Ky është lloji i letrës Watermark. Dhe për këtë arsye ajo ka një standart më të lartë, një peshë më të lartë është 90 gr/m².

Z. M. Çakaj: Atëherë, nëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përfiton një letër 92 gr apo 95 gr i vlen KQZ-së, a shërben kjo si dendësi letre për fletë votimi? A është e përshtatshme?

Zj. H. Vukaj: Duhet patjetër 90, kjo është ideja!

Z. Y. Merkaç: Kur paloset letra, nëse është më e madhe se 90gr/m² mund të mbushet më shumë kutia e votimit.

Z. M. Çakaj: Po pra, po të gjitha këto sqarime a do ishte mirë ti saktësoni në relacion? Sepse ne si Komision Rregullator që do të duhet që të miratojmë një karakteristikë teknike së pari duhet të jemi ne të bindur për këto karakteristika, arsyet se pse vendosen këto, qëllimin që ka qoftë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe të gjitha këto sëbashku t'i materializojmë në një akt. Pra, nëse ne shprehemi dendësia e letrës apo thurrje termi i duhur duhet të jetë "jo më pak se 90gr/m²" a jemi korrekt? A e arrijmë qëllimin? Pra jo më pak se 90 gr nënkupton 90 gr e sipër. E arrijmë qëllimin tonë për të pasur një fletë votimi i cili do të ketë jo vetëm dendësinë, ngjyrën, trashësinë apo elementët e tjerë në respekt të nenit 98 pika 1 të Kodit Zgjedhor. E arrijmë ne qëllimin?

Z. Y. Merkaç: E arrijmë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Z. B. Kodra: Besoj, nëse vendosim përcaktimin jo më pak se 90gr.

Z. M. Çakaj: Dakord!

Zj. I. Nano: Lidhur me karakteristikën e parë lloji i letrës, keni ndonjë pyetje tjetër apo të votojmë propozimin?

Z. M. Çakaj: Jo vetëm të sqarohet në kllapa Watermark dhe të jetë termi i duhur shqipëtarë ose dendësia.

Zj. I. Nano: Le të gjendet termi i duhur.

Z. M. Çakaj: Ose trashësia jo më pak se 90 gr.

Zj. I. Nano: Ndryshimi i propozuar është që këtu të kemi “jo më pak se 90 gr/m²” dhe ai është rregullim që e bën administrata për ta përcaktuar në shqip.

Z. M. Çakaj: Po, termi shqiptar.

Zj. I. Nano: E shoqësuar në kllapa me termin në anglisht.

Zj. H. Vukaj: Sigurisht por e shoqëruar kjo me shpjegime të detajuara justifikuese në relacionin që do të vijë aktit në momentin e...

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Zj. I. Nano: Dhe në relacion të gjitha ndryshimet e mundshme dhe kërkesat që po diskutohen.

Zj. H. Vukaj: Nuk votohet akti pa ardhur relacioni që e justifikon.

Z. Y. Merkaj: Por ju po shkoni drejt vendimmarrjes.

Zj. H. Vukaj: Jemi tek pjesa ende...

Zj. I. Nano: Në çdo rast relacioni i bashkëlidhet aktit që besoj do të miratohet dhe do të jetë udhëzues edhe për administratën në momentet e proceseve të tjera që do të vijojnë më tej.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Znj. I. Nano: Në çdo rast relacioni i bashkëlidhet aktit që besoj duhet të miratojmë dhe duhet të jetë dhe një udhëzues për administratën në momentet e proceseve të tjera që vijojnë më tej.

Znj. H. Vukaj: Pastaj dhe procesimi dhe bari ka vlerë të cilën ju e dini si jurist se çfarë përfaqson!

Z. A. Kaziaj: Në një moment të tillë në momentin e duhur ta kemi përpara domethënë para pak kohësh që ne ta marrim parasysh dhe relacionin e sjellë siç me të drejtë e kërkuat dhe ju dhe zonja Vukaj, fakti është që duhen lidhur me nëqoftëse më lejon kryetarja,

Znj. I. Nano: Nëqoftëse ke diçka lidhur me karakteristikat teknike një propozim, një pyetje për administratën patjetër që je i lejuar.

Z. A. Kaziaj: Që mund të jetë ekspost pas vendimarrjes tuaj dhe pjesa e llojit të letrës 90gr/m² që jo më pak e vuri Komisioni Rregullator.

Znj. I. Nano: Do t'a votojmë!

Z. A. Kaziaj: Dakord, do ta votoni atë gjë dhe besoj se do jetë një vështirësi për më tej për të bërë atë që është për procesin e administratës që do shkojë të prokurojë le të themi letrën se mos sjelli karton se i vini dyshtemenë jo më pak dhe mund të sjelli dicka më shumë. Keshtuqë do jetë vështirësi besoj për ta,

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çakaj.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Znj. H. Vukaj: Kisha një ndërhyrje të vogël që jo vetëm antarët por edhe përfaqësuesit të kuptoni njëkohësisht dhe publiku. Një pyetje për administratën. A keni pasur pretendime apo ankesa në gjithë eksperiencën zgjedhore për mungesë cilësie e garancie me këto karakteristika apo specifikime siç i quani ju, për letrën e standartizuar në 90 gr meqënëse ju e keni bërë standart. A ka pasur pretendime që shiko se vota u duk, vota ishte jo më e fshehtë por e lexoi dikush?

Z. B. Kodra: Në dijeninë time, jo. Nuk ka pasur asnjëherë. Ka qenë letra më e përshtatshme për të prodhuar fletën e votimit.

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çakaj. Pra jo më pak se 90gr/m2.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj. Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Ndërkohë sa për karakteristikën e parë do t'i lutesha administratës për të përshtatur në shqip termin 'Watermark' dhe pastaj ta vendosim në kllapa atë.

Kalojmë te karakteristika tjetër: dimensionet e fletës së votimit. Këtu jemi gjithmonë tek fleta e votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie.

Gjerësia e fletës së votimit jo më e vogël se 210 mm

Gjatësia e fletës së votimit jo më e vogël se 297 mm

Siç e ndoqëm nga relatimi i Sekretarit të Përgjithshëm nënkupton një format jo më të vogël se A4. Do t'a vijoja dhe me 'Orientimi i fletës së votimit që është portret', pra në këtë mënyrë do të jetë fleta e votimit ose propozohet të jetë fleta e votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie. Kolegë lidhur me këtë karakteristikë teknike kemi diçka? Atëhere kalojmë në votimin e karakteristikës së dytë, pra dimensionet e fletës së votimit dhe orientimi I fletës së votimit.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në rubrikën tjetër.

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra, dimensione: 16 x 19.5 mm

Logo KQZ, me ngjyra, dimensione: 19 x 19 mm

Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës

(CorelDRAW): Panton 108 C (R 247, G219, B 23) 60%

Nëse kemi nevojë edhe këtu për sqarime nga ana e kolegëve të administratës.

Qoftë për përmasat e stemës, logos dhe kodi i ngjyrës mesa kuptoj kjo tjetra është kodi i ngjyrës mesa kuptoj unë. Po zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Po, atëherë lidhur me stemën e Republikës me ngjyra dhe logon e KQZ-së përsëri me ngjyra së pari unë mendoj që nga ana e Komisionit Rregullator do të ishte e mjaftueshme të miratoheshin këto dy karakteristika. Pra edhe stema e Republikës edhe logoja e KQZ-së në momentin që themi me ngjyra besoj është e mjaftueshme, pra t'i heqim përmasat të cilat janë në krahë së pari, së dyti lidhur me ngjyrën e fletës së votimit që kemi dhe kodin e ngjyrës unë do të dëshiroja nga KQZ nëse kemi ndonjë model e cila prezanton ngjyrën që do të ketë fleta e votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie.

Z. B. Kodra: Ngjyra e propozuar në projektvendim është e njëjtë me atë të përdorur në zgjedhjet pararendëse të vitit 2019 dhe 2015, kodi është kodi i ngjyrës po që në gjuhën teknike një ngjyrë prezantohet me ato kode. Realisht ngjyra reale është kjo, kjo është një fletë votimi e 2019 për Kandidatin për Kryetar.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Znj. I. Nano: Për kandidatin për Kryetar, ngjyra e verdhë.

Z. B. Kodra: Kjo është një fletë votimi e prodhuar për vitin 2019. Pra të gjithë ato numrat kthehen në këtë lloj ngjyre.

Znj. I. Nano: Dhe për zgjedhjet e vitit 2022-shit të pjeshmet besoj.

Z. B. Kodra: Jo, në zgjedhjet e 2022-shit u bënë pa ngjyrë, në zgjedhet e pjeshme u bënë të bardha.

Znj. I. Nano: Ketu kemi dy ngjyra sipas nenit 97, meqë janë dy fletë. Atëherë në përfundim të këtij diskutimi propozimi kush është?

Z. M. Çakaj: Atëherë në përfundim të këtij propozimi meqënëse u sqaruar dhe për modelin me ngjyrën përkatëse të fletës së votimit për Kandidat për Kryetar Bashkie, propozimi konkret ngelet të hiqen dimensionet nga ky akt, nga lidhja numër 1. Dimensionet qoftë të stemës së Republikës, qoftë të logos KQZ-së. Kjo është për t'i dhënë dhe pak fleksibilitet administratës KQZ-së në momentin e kompozimit final të fletës së votimit. Pra e ka në dorë vetë administrata ta kompozojë, logon, dimensionet, qoftë të logos qoftë të stemës së Republikës.

Znj. I. Nano: Zoti Kaziaj, kishit diçka?

Z. A. Kaziaj: Po, nëqoftëse është e udhës besoj se te kjo pjesa e lidhjes 1 mos do duhet që të ishte dhe specifika se ku do jetë stema e logos, më falni logo e KQZ-së dhe logo e Republikës së Shqipërisë. Në cilën pjesë të fletës meqë fleta do jetë në pjesë siç thatë dhe ju portret, në cilën pjesë? Në pjesën e majtë sipër, në qendër të fletës së votimit apo djathtas saj? Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Znj. I. Nano: Në fakt zoti Kaziaj faleminderit për ndërhyrjen, ajo çka ne si Komision Rregullator kemi diskutuar që në krye të herës në mbledhjen e kaluar ku kemi miratuar disa karakteristika për kamerat, për shkak të organit të cilit përfaqësojmë dhe të kompetencave të tij ne kemi përsëritur më shumë se një herë faktin që nuk jemi njësi prokurimi për të shkuar në detaje kaq të holla. Kështu që ne miratojmë sot disa karakteristika teknike që duhet t'i ketë domosdoshmerisht fleta e votimit, një pjesë e të cilave sipas nenit 98 lidhen edhe me elementë sigurie, me trashësinë që të mos lejohet leximi në anën tjetër. Pra, jemi duke reduktuar specifikimet në karakteristika teknike. Më tej do duhet të bënim dizajnin. Megjithatë për momentin kemi një propozim nga ana e zotit Çakaj. Ju do t'i qëndronit një propozimi për të vendosur majtas, djathtas përmasat e stemës?

Z. A. Kaziaj: Po, meqë kemi administratën këtu të ftuar që të na thotë pak sesi është zgjedhur kjo pjesë në pjesën e zgjedhjeve pararendëse le të themi të paktën për këtë pjesë.

Z. Y. Merkaç: Në të gjitha fletët e votimit stema e Republikës ka qenë lart majtas, ndërsa logo e KQZ-së ka qenë djathtas lart.

Znj. I. Nano: Pra është një standart i konfirmuar tashmë dhe i provuar. Dakord, atëherë kalojmë në propozimin, në votimin e propozimit të zotit Çakaj për heqjen nga kjo rubrikë e dimensioneve të stemës së Republikës dhe të logos së KQZ-së. Ngjyra e fletës deri tani skemi ndonjë propozim, vetëm dimensionet e stemës dhe të logos KQZ-së. Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj për të hequr nga projektvendimi konkretisht nga lidhja 1, dimensionet e stemës së Republikës dhe logos së KQZ-së? Votojmë këtë propozim njëherë ju lutem.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në rubrikën e fundit.

Barkodi (elementë teknikë në formën e kodeve):

- Numri serial 7 shifra
- Qarku 2 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra

dhe elementin ndarës “/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

Kemi diçka lidhur me këtë rubrikë? Po, zonja Vukaj?

Z. H. Vukaj: Nisur nga fakti dhe eksperiencia e zgjedhjeve të kaluara ku ka pasur pikëpyetje, dilema, qasje të larmishme në lidhje me sigurinë apo me se çfarë përfaqësonte i gjithë ky përshkrim, do doja që të garantonim të gjitha palët që bëhet fjalë për një barkod të fshehur, gjë e cila meriton të shprehet edhe këtu në mënyrë literale. Pra barkodi (elementët teknikë në formën e kodeve) meriton që të ketë fjalën “të fshehura”, me qëllim që asnjë mos të ketë pikëpyetje ose të hamendësojë se vota lexohet apo fleta e votimit është e deshifrueshme.

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj, duke patur parasysh dhe zgjedhjet e kaluara këto nuk janë të gjithë element që janë të fshehur. Pra ka elementë që janë të lexueshëm të dukshëm që identifikojnë që janë për cilën zonë zgjedhore dhe për cilën qendër votimi ato fletë që prodhohen. Kështu që për më tepër nga administrata nëse mund të na thoni,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Z. H. Vukaj: A e bëjnë atëherë administrata këto barkodi ose ky përshkrim që keni sjellë ju të lexueshme votën e votuesit? Më e thjeshtë pyetja.

Z. B. Kodra: Referuar përcaktimit të nenit 98 thotë fleta e votimit përmban element teknik në formën e barkodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit si dhe elementë të tjerë identifikues që nuk lexohen me sy të lirë. Pra në zbatim të këtij përcaktimi ajo që ne kemi përdorur në gjithë zgjedhjet pararendëse ka qenë që numri i zonës dhe numri i QV-së është i dukshëm dhe printohen në fletët e votimit. Ky element është vendosur që në zgjedhjet e vitit 2015, po ta shikoni këtu çdo fletë votimi ka në fund të dukshme numrin e zonës zgjedhore dhe numrin e qendrës së votimit. Ndërsa kodi i padukshëm është barkodi është ky këtu i cili përbëhet nga ato element që ju lexuat. Që është ka një numër serial 7 shifror, dy numra që identifikojnë qarkun, dy numra identifikojnë bashkinë, dy numra zonën zgjedhore dhe gjashtë shifra që identifikojnë qendrën e votimit. Gjithë ky kod 18 shifror është i padukshëm. Domethënë i padukshëm me sy të lirë por që lexohet me aparatën përkatës dhe printohet në këtë pjesën që quhet barkodi.

Z. H. Vukaj: Pikërisht pra që mos konfundojmë njërën me tjetrën, kam përshtypjen që bëhet fjalë për atë që unë ngrita, për një kod të fshehur apo jo? Ç'të keqe ka që ne të shtojmë fjalën 'i fshehur' aty në këtë barkod?

Znj. I. Nano: Ose t'i ndajmë këtu kemi pesë elementë nga të cilët një pjesë janë që nuk lexohen me sy të lirë, ndërsa ato që lexohen me sy të lirë mund të jenë një rubrikë më vete. Dhe që nuk lidhen me identifikimin e votës. Po zoti Çakaj.

Z. D. Çaka: Atëherë edhe nga sqarimi juaj zoti Kodra behet fjalë për dy elementë të veçantë. Pra nga njëra anë që është barkodi i cili përmban elementë të fshehur,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

dhe në krahun tjetër janë dhe dy elementë siç janë zonat e administrimit zgjedhor dhe numri i qendrës së votimit. Ndërkohë nëqoftëse do të mbajmë këtë karakteristikë të pestë këto elementë janë pjesë të barkodit sipas aktit. Tani në fletën e votimit të pestë këto elementë janë pjesë e barkodit apo vetëm tre elementet e para dhe dy të fundit janë pjesë të veçanta të dukshme në fletën e votimit?

Z. B. Kodra: Në fletën e votimit të pestë këto element janë pjesë e barkodit dhe veç këtyre në mënyrë të dukshme janë vetëm dy element.

Z. D. Çaka: E kuptoj. Dakord!

Znj. H. Vukaj: Atëherë ka nevojë të ndahet, elementët e ekspozuar dhe elementët e fshehur që garantojnë mosleximin.

Znj. I. Nano: Unë mendoj nëqoftëse këta të pestë elementë janë elementë të barkodit t'a lëmë kështu dhe të vendosim një rubrikë poshtë barkodit për dy elementët që janë të lexueshëm. Të pestë janë njëherë pjesë e barkodit. Përveç se pjesë e barkodit janë dhe dy të dukshëm. Pra të shtohet rubrika me elementët e dukshëm. Se çfarë janë pjesë e barkodit është e kuptueshme që janë të padukshëm. Një rubrikë e re. Po ke thënë barkod është i padukshëm.

Znj. H. Vukaj: Dakord, ne hasemi në paqartësinë tonë pikë së pari e jo më në të atyre që do t'a marrin ta lexojnë. Ata dhe gjithëkushi që është i interesuar që t'a analizojë me lupë këtë lloj vendimi le ta ketë të shkruar aty elementë teknik që t'i japi garanci maksimale në formën e kodeve të padukshme. Dhe pastaj,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Znj. I. Nano: Dhe një rubrikë e dytë element teknik të dukshme, të lexueshme në fletën e votimit. Të dukshme se të lexueshme duket sikur të krijon idenë e leximit dhe nga pas. Pra për këtë rubrikë të specifikimeve të karakteristikave teknike kemi dy propozime:

Të shtohet fjala të padukshme ose të fshehura ajo që është më e përshtatshme me barkodin dhe të shtohet një rubrikë e dytë elementë teknikë të dukshëm ose të lexueshëm në fletën e votimit. Kolegë kemi propozim tjetër për këtë rubrikë? Nëse jo kalojmë në votimin e këtyre dy propozimeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në lidhjen numër 2 që janë:

Specifikimet e fletës së votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Unë do të përsëris minimumi ato propozime që u bënë dhe që u votuan dhe i rivotojmë sepse kjo është një pjesë tjetër. Kemi disa karakteristika të fletës së votimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Rubrika Lloji i letrës sqarimi në shqip i fjalës watermark dhe vendosjen e watermark në kllapa dhe pas saj jo më pak se 90 gram për m2.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Dimensionet e fletës së votimit nuk kishim në lidhjen 1. Po zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Për merak më tepër ose për edhe qartësim këtu dhe më pas kur të zbardhet. Me fjalën elementë në printim që shikohen me rreze ultraviolet. E keni fjalën elementë sigurie në numrin njëjës apo në shumës, sepse nëqoftëse është shumës duhet gramatikisht 'Ë' në fund.

Z. B. Kodra: Duhet të jenë në numrin shumës pasi janë disa elementë që shikohen me rreze ultraviolet, nuk është vetëm një. Që bëjnë pjesë në elementët e sigurisë që përmban fleta votimit.

Znj. I. Nano: Atëherë redaktim kërkon kjo e lëmë elementë dhe tek lidhja 1 dhe tek lidhja 2. Tek dimensione e fletës së votimit nëse në lidhjen numër 1 ne nuk bëjmë ndryshime. Gjithsesi e kalojmë për votim tek lidhja numër 2.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Tek Specifikime të përgjithshme kemi hequr fjalën dimensione dhe dimensionet e shprehura në milimetra. Kemi ndonjë propozim tjetër meqë jemi këtu në këtë pikë nëse mundet të demonstrojmë edhe ngjyrën e fletës së votimit për kandidatët. Pra ky kod,

Z. B. Kodra: Ky kod ngjyra është fleta e votimit që është e njëjtë me fletën e votimit të prodhuar në vitin 2019

Znj. I. Nano: Pra dhe orientimi është peisazh.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Z. B. Kodra: Dhe orientimi është landscape ose peisazh ashtu siç është propozuar në projektakt.

Znj. I. Nano: Atëherë votojmë propozimin për të hequr fjalën dimensione dhe dimensionet të shprehura në milimetra për stemën e Republikës dhe logon e KQZ-së.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Në rubrikën e fundit të lidhja 1 patëm dy propozime të votuara, pra për të shtuar fjalën të fshehura të barkodi dhe për të shtuar rubrikën me dy elementët që janë të dukshëm në fletën e votimit. Nëse skeni propozim tjetër për këtë rubrikë kalojmë në votimin e kësaj rubrike në lidhjen 2 me dy ndryshime të cilat u miratuan më herët të lidhja 1? Kolegë,

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Atëherë deri tani shqyrtuam lidhjen 1 dhe lidhjen 2 kështu që më duhet të kaloj në votimin e pikës 1. Miratimin e specifikimeve teknike të fletëve së votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.31.01.2023*

Pika 2. Në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen brenda afatit ligjor, mund të ndryshohen përmasat e fletëve të votimit. Është argumenti që Sekretari I Përgjithshëm e parashtrori gjatë prezantimit të projektaktit. Kemi diskutime të kalojmë në votim për këtë pikë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë Brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë tashti me miratimin në tërësi të projektvendimit pasi e kemi shqyrtuar dhe miratuar në parim dhe nen për nen. Kolegë edhe njëherë vullnetin tuaj.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Meqënëse nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për të trajtuar mbledhjen e shpall të mbyllur!

Vendimi nr. 2

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

